



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primiten/Prodato Received/Delivered	07.04.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTK	3441/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.339/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.339/2023 të datës 08.02.2023 të parashtruar nga ankuesi nga Gjakova, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 05.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.339/2023 e datës 08.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. *Ndryshohet* Formulari i datës 31.01.2023 për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen, lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit, dhe atë nga nota 2.2-mjaftueshëm, në notën 3 mirë.
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesen si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civile.
- IV. *Obligohet* Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Birimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Ankuesja punësuar në Komunën e Gjakovës, më datë 08.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolloi 1578/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, për shkak të cenimeve të rënda të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Gjakovës. Ndërsa, Këshilli me datë 23.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me Vendimin me numër protokolloi 2896/2023 të datës 22.03.2022 të Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është shtyrë afati për vendosjen e ankesës A.nr.339/2023 të datës 08.02.2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolloi 1578/2023 të datës 08.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 31.01.2023; Shkresën për notën mesatare të Sektorit të Gjendjes Civile; Raportin e të hyrave sipas drejtorive në raport me planin për vitin 2022; Raporti vjetor i ankueses për ngarkim, shkarkim me certifikatat të gjendjes civile i datës 22.12.2022; Raporti për lëshimin e certifikatave për vitin 2022 i datës 12.01.2023; Raportin vjetor për regjistrim lindje, martesë dhe vdekje brenda dhe jashtë vendit i datës 22.12.2022; Raporti vjetor nga 01.01.2022 deri 15.12.2022 për fitim, rifitim dhe refuzim të shtetësisë i datës 22.12.2022; Raporti i vendimeve për regjistrime të lindjeve, vdekjeve dhe për ndërrime dhe korrigjime për periudhën 01.01.2022 deri më datë 15.12.2022 i datës 22.12.2022; Kërkesën për Komision Disiplinor e datës 28.06.2022 nga ankuesja; Vendimin A.nr.713/2022 i datës 14.10.2022 i Këshillit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.01.2022; Vendimin A.nr.108/2022 i datës 28.03.2022 i Këshillit; Vendimin me numër 01-070/01-1077 i datës 28.04.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës; Vërejtjen e datës 18.10.2022 për ankuesen; Vendimin A.nr.957/2022 i datës 07.12.2022 i Këshillit; Zarkin e datës 06.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolloi 1929/2023 e datës 20.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolloi 2017/2023 e datës 23.02.2023; Emailin e datës 23.02.2022 nga K.A për T.K; Akt Emërimit AE.Nr.01-112/02-37391 i datës 13.12.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile; Formularet për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 13.04.2022, 14.04.2022 dhe 29.01.2021; Vërejtjen e datës 16.06.2021 për ankuesen; Vendimin me numër protokolloi 2896/2023 të datës 22.03.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, emali i datës 6.05.2023 nga KPMSHCK për ankuesin, dhe emalin e datës 06.04.2023 të ankueses për KPMSHCK fq.1/2* të bashkangjitur edhe raporti për periudhën 01.01.2022 deri 15.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuar pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Komunën e Gjakovës dhe se e njëjta sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.01-112/02-37391 të datës 13.12.2021 ushtron pozitën e punës *Udhëheqëse e Sektorit të Gjendjes Civile*, në Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative.

Me tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme dhe Administratë, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses, me datë 31.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022, me notë të përgjithshme *2.2-njaftueshem*.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Shton së vlerësimi është jo i drejt dhe subjektiv sepse kam përmbushur të gjitha objektivat e Sektorit të gjendjes civile.

Sipas përgjigjes në ankesë, Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative në Komunën e Gjakovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses, ka theksuar së vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses për vitin 2022 e bazon në faktet së ankuesja asnjëherë nuk ka dërguar raporte javore dhe vjetore të mbikëqyrësi i saj dhe se nuk ka përgatit plan vjetor të punës.

Kolegji në kuptim të vendosjes meritorie i'u referua nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit....*

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, përkatësisht nenin 5 ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese*

(vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë.

Në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur së Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative në Komunën e Gjakovës, në cilësi të vlerësuesit, vlerësimin e ankueses lidhur me rezultatet në punë për vitin 2022 e bazon vetën në faktin së ankuesja nuk ka dërguar raporte javore dhe vjetore të mbikëqyrësi i saj dhe së nuk ka përgatit plan vjetor të punës, ndërsa ndërlidhur me fakt, Kolegji në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë sipas të cilës dëshmohet së Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative të ketë kërkuar nga ankuesja që të raportoj në baza kohore të caktuara (javore, mujore, apo tre mujore) apo së ankuesja të ketë refuzuar raportimin në bazat kohore të përcaktuara nga vlerësuesi.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së Sektori i Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës nuk ka miratuar Planin e Objektive të Punës për vitin 2022, i cili plan duhet të përmbaj objektivat dhe aktivitetet për përmbushjen e këtyre objektivave dhe rrjedhimisht mbi bazën e këtij plani duhet të përcaktohen objektivat e vlerësimit të ankueses si Udhëheqëse e Sektorit të Gjendjes civile. Rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit përgatitja e Planit Objektiv të Punës për Sektorin e Gjendjes Civile bie në përgjegjësi të mbikëqyrësit në këtë rast Drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe nëpunësit civil gjegjësisht ankueses në cilësi të Udhëheqëses së Sektorit të Gjendjes Civile. Andaj, mos përgatitja dhe mungesa e planit objektiv të punës konsiderohen mosveprim dhe bie ndesh më përcaktimin ligjor sipas 6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, ku në mënyrë shprehimore është paraparë se : *Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet. 2. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë. 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit. 5. Në rast ndryshimi të objektivave brenda vitit të vlerësimit, zhvillohet e njëjta procedurë sipas paragrafëve 1 deri 4 të këtij neni për pjesën e mbetur të vitit të vlerësimit.*

Në mungesë të objektivave të punës, Kolegji i Këshillit mori parasysh detyrat që bien në fushëveprimin e Sektorit të Gjendjes Civile e mbi këtë bazë ka analizuar Raportin e të Hyrave sipas Drejtorive të Komunës së Gjakovës nga dhe ka konstatuar së planifikimi vjetor për 2022 lidhur me Drejtorin e Përgjithshme/Sektorin e Gjendjes Civile ka qenë 120.000.00 €, ndërsa realizimi i të hyrave nga taksat nga ky sektor është 128.694.50€ apo 107.25 %. Kurse sipas Raportit të Punës të dërguar nga ankuesja për mbikëqyrësin më datë 22.12.2022 rrjedhë së Sektori i Gjendjes Civile në Gjakovë për periudhën 01.01.2022 deri me 15.12.2022 ka lëshuar gjithsej 121.329.00 certifikata të gjendjes civile, duke përfshirë 1.609 shërbime për regjistrim lindje brenda vendit, 355 shërbime për regjistrim të lindjeve botës së jashtme, 743 shërbime për regjistrim të martesës brenda vendit, 151




shërbime për regjistrim të martesave të botës së jashtme, 573 shërbime për regjistrim të vdekjes brenda vendit, 91 shërbime për regjistrim të vdekjes në botën e jashtme, 934 korrigjime të lindjeve, 111 regjistrimi të vdekjeve më vonesë, 89 regjistrimeve të lindjeve më vonesë, 38 vendime për ndërrim dhe korrigjime, 6 fitime të shtetësisë, 11 rifitim të shtetësisë, 266 lirim i shtetësisë dhe 12 refuzime të shtetësisë, andaj, mbi gjendjen e këtyre evidencave, rezulton së vlerësimi i ankueses me notën e përgjithshme 2.2-*mjaftueshëm* nuk është vlerësim i drejtë dhe nuk përkon më detyrat e realizuara, kështu që Kolegji në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: “*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)..*”vendosi që të ndryshoj Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesen, ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare dy pikë dy (2.2), ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare tre (3), e që në kuptim të nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin “mirë”, ngase siç u konstatua më lart ankuesja ka argumentuar mjaftueshëm me prova material se ka realizuar detyrat e punës dhe ka treguar gjithashtu aftësi të pritshme të punës.

Theksuar si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.339/2023

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;